



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-401-11923, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

### **VENDIM**

### **PËR LEJIMIN E MJETEVE BUXHETORE PËR NDIHMË FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE**

#### **Neni 1**

Lejohen mjete buxhetore për ndihmë financiare për 37 ( tridhjetë e shtatë) persona në gjendje të rëndë sociale dhe shëndetësore, në shumë të përgjithshme 3700.00 €.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

#### **Neni 2**

Mjetet buxhetore sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve n'kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### **Neni 3**

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**Nr.02-005-50401**  
**Podujevë**  
**20 qershor 2016**

**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**